



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА  
KOMUNA E GRAÇANICËS  
MUNICIPALITY OF GRAČANICA

Në bazë të nenit 443 dhe nenit 47 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 5 të Udhëzimit administrativ nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të komunës, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës thërret mbledhjen e rregullt dhe dërgon:

### FTESË

I nderuar,

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e pestë të rregullt të Kuvendit Komunal të Graçanicës, e cila do të mbahet të premten më datën 07.06.2024. Mbledhja do të fillojë në orën 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit, kati i parë nr. 2.11 në objektin e Komunës së Graçanicës në Graçanicë.

Të bashkëngjitur me ftesë gjeni rendin e ditës dhe materialin për këtë mbledhje.

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

### REND I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e rregullt, e mbajtur më datën 17.05.2024.
2. Informata për Qarkoren buxhetore 2025/01, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë për periudhën 30.05.2023 - 01.12.2023, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Nebojsa Nikolliq.
4. Informata për ndarjen e subvencioneve nga fusha e bujqësisë për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Nebojsa Nikolliq.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për dhënien e pëlqimit për kërkesën për vendosjen e simbolit të flamurit të komunitetit serb-kombëtar, me rastin e shënimit të festës së 28 qershorit 2024 – "Vidovdan", me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksat, tarifat dhe gjobat komunale nr.01/2021/KG (nr. protokolli 890/21 e datës 26.02.2021), me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër – lokalit në Suhadoll, kompanisë Jugo Market D.O.O., me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër – lokalit në Suhadoll, kompanisë Nikola Nedeljković I.B. me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës dhe biznesit të NPK “Ekologjia” Sh.A. Graçanica për periudhën janar – dhjetor 2023, me propozim të drejtorit ekzekutiv të NPK “Ekologjia” Sh.A. Graçanica, Dejan Dimitrijeviq.
10. Formimi i grupit punues për hartimin e Planit të veprimit për procedurën transparente të buxhetimit, me propozim të kryesuesit të Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.
11. Të ndryshme.

Me respekt,

Kryesuesi i KK të Graçanicës

Milan Dimitrijeviq

